

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese dhe Organizata ÇOHU! kanë bërë klasifikimin dhe gjetjen e përfituesve të tenderëve publikë në KEK që nga viti 2007, por vetëm të tenderëve me vlera të mëdha.

Vlera e krejt këtyre tenderëve, mbi të cilët ka hulumtuar QKGH-ja, është rreth 550 milionë euro.

Më poshtë janë emrat e 200 kompanive si dhe shumat e përfitimeve të tyre nga kjo korporatë:

1. **“ABB”** kompani nga Kroacia e që për person kontaktues në Kosovë e ka Zheljko Pajiq, nga KEK në vitin 2008 ka marrë një tender në vlerë prej 761 mijë euro.
2. **“ABB Power System Substations”**, kompani nga Kroacia e që për person kontaktues në Kosovë e ka Mladen Rakic, nga KEK ka marrë punë për projektim dhe ndërtim, në vitin 2010 dhe 2011, dy tenderë në vlerë mbi 11.8 milionë euro.
3. **“ABB Zagreb”**, po ashtu është kompani nga Kroacia që ka përfituar tender në KEK. Ajo për përfaqësues në Kosovë ka Darijo Jarak. Kjo kompani nga KEK-u në këtë vit ka marrë një tender prej afro 2.7 milionë eurosh.
4. **“AC/DC”**, pronë e Arben Gashit nga Prishtina në vitin 2008 ka qenë përfituese e tenderit ‘Furnizimi me Reduktor dhe pjesë rezervë’, në vlerë mbi 370 mijë euro.
5. **“ACDC-Kos”**, pronë e Ilmi **Zhugollit** e Rexhep **Zhugollit** që nga viti 2007 e deri në vitin 2008 ka përfituar nga KEK-u mbi 10 tenderë publikë, vlera e përbashkët e të cilëve është mbi 23.2 milionë euro.
6. **“ADRIA 7”**, që për pronar e ka Sabit Krasniqin, ka marrë në vitin 2010 një tender prej mbi 770 mijë eurosh., për Furnizim me poqa dhe reflektor”Në po këtë vit, për tenderin “Furnizim me Aparate Digitale”, kjo kompani është penalizuar nga KEK për mos përmbushje të kontratës.
7. **“Aero Com”** që për pronar e ka Xhelal Nezirin e person kontaktues për tenderët në KEK Nexhmedin Nezirin, nga kjo korporatë në vitin 2012 ka përfituar një kontratë prej 2,961.00
8. **“Alba”** kompani nga Fieri (nuk është gjetur emri i pronarit dhe vetë kompania regjistri në ARBK), ka përfituar nga KEK-u në vitin 2009 një tender prej 174 mijë eurosh.
9. **“Alkom”**, pronë e Sadri Avdiut nga KEK-u është shpërblyer në vitin 2007 me tenderin për ndërtimin e “Punëtoritë për intervenime elektrike dhe makinerike në DPQ”, që peshon mbi 400 mijë euro.
10. **“Alstom Power Service”**, kompani ndërkombëtare që përfiton tenderë publik në Kosovë, nga KEK-u prej vitit 2008 e deri tani ka marrë, vetëm te kategoria e tenderëve të mëdhenj, tenderë në vlerë mbi 20.5 milionë euro.
11. **“Altima”**, kompani e Kroacisë në Kosovë, nga KEK ka përfituar një tender për furnizim me pajisje për komunikim që peshon afro 200 mijë euro.
12. **“Arb Com”**, pronë e Bashkim Halitit nga Prishtina, nga KEK-u në vitin 2011 ka përfituar tenderin “Furnizimi me reduktor”, që peshon mbi 165 mijë euro.
13. **“Arb Commerce”**, pronë e Alban Azemit nga Prishtina, në vitin 2010 është shpërblyer nga KEK-u me tenderin “Furnizim, mbikëqyrje dhe mbrojtje nga korrozioni te pajisjeve kryesore xehetareë ne DPQ”, që peshon afro 390 mijë euro.
14. **“Arta Tex”** pronë e Agim Mustafës nga Peja në vitin 2011 është shpërblyer nga KEK-u me tenderin “Furnizim me mjete mbrojtëse në punë”, që peshon mbi 300 mijë euro.
15. **“ART-TRA”**, kompani nga Italia që për person kontaktues e ka Carla Gelsumini në vitin 2010 është shpërblyer me një tender për furnizim me transformatorë në vlerë prej afro 600 mijë eurosh.

16. **“As com Group”**, pronë e Abdyl Kelmendit, e që për person kontaktues në tenderët në KEK ka Xhevdet Thaqin, nga kjo korporatë ka përfituar në vitin 2009 dy nga tenderët e mëdhenj të KEK-ut, që peshojnë afro 330 mijë euro.
17. **“As Vali”**, kompani nga Prishtina, (nuk kemi mundur të gjemë emrin e pronarit në ARBK), në vitin 2009 ka përfituar tre tender nga KEK-u që peshojnë bashkë afro 700 mijë euro.
18. **“Atlas”**, pronë e Labinot Sylës nga Prishtina, nga KEK në vitin 2009 ka përfituar tenderin “Liferimi dhe montimi i pjesëve ne tornot ne FPX – Palaj” që peshon mbi 112 mijë euro.
19. **“ATM PR”**, pronë Agim Kostari e Gjergji Kostarai nga Prishtina, nga viti 2008-2011 ka përfituar nga KEK-u tender në vlerë mbi 865 mijë euro.
20. **“Audit Group”**, pronë e Avni Musliut nga Prishtina, nga viti 2009-2012 ka përfituar nga KEK-u tre tenderë të mëdhenj, që së bashku peshojnë mbi 340 mijë euro.
21. **“Aulona”**, pronë e Hamdi Krasniqit e Murteza Beqirit që nga viti 2007-2012 ka përfituar nga KEK tenderë, të klasifikuar si tenderët e mëdhenj, në vlerë prej mbi 1.7 milion eurosh.
22. **“Auto Kosova”**, pronë e Nazif Hotit e që për preson kontaktues e ka edhe Emin Sabedinin, nga KEK-u që nga viti 2008-2012 ka përfituar tenderë në vlerë afro 460 mijë euro.
23. **“Auto Mita”**, pronë e Blerim Mitës nga Prishtina në vitin 2011 nga KEK-u ka përfituar tenderin “Furnizim me pjesë ndërrimi për mekanizmin “MERCEDES”, tender që peshon 80 mijë euro.
24. **“Autoservis Sistem”**, pronë e Ramadan Raçit nga Obiliqi në vitin 2011 ka përfituar nga KEK-u tenderin “SERVISIMI DHE MIREMBAJTJA PER AUTOMJETE SPECIALE”, që peshon 325 mijë euro.
25. **“B&D Engineering”**, pronë e Albana Zeqiraj Hotit nga Prishtina ka përfituar në vitin 2011-2012 nga KEK-u tenderë që peshojnë afro 340 mijë euro. Natyra e furnizimeve që KEK ka blerë nga kjo kompani janë kushineta, izolatorë e siguresa.
26. **“B&L”**, pronë e Lumnije Shalës nga Prishtina në vitin 2011-2012 nga KEK ka përfituar tenderë që peshojnë afro 780 mijë euro. Tenderët janë kryesisht për furnizim me elektromotorë.
27. **“Bagdat”**, kompani nga Prishtina që për pronar ka biznesmenin Sabri Zejnullahu, nga KEK-u në vitin 2009 është shpërblyer me tenderin “Furnizim me : Orman për trafo – shtylla”, që peshon afro 200 mijë euro.
28. **“Ballkan Petrol”**, pronë e Bekim Halitit nga Ferizaj, nga KEK-u prej viti 2008-2012 ka përfituar tenderë në vlerë mbi 5.7 milion euro. KEK nga kjo kompani është furnizuar prej vajrave industrial, te transformatorët e deri te motorët për pompa.
29. **“Bel Ju Trade”**, kompani nga Maqedonia që person kontaktues ka Agim Kongjelin, nga KEK-u është kontraktuar një herë në vitin 2007 dhe një herë në vitin 2009 për furnizim me kemikalje. Vlera e këtyre tenderëve, së bashku, arrin në mbi 400 mijë euro.
30. **“Beli Com”**, pronë e Selami Ismajlit nga Vitia nga KEK-u ka përfituar dy tenderë në vitin 2011, një për furnizim me kamion vinç dhe një për furnizim me pjesë rezervë për këtë kamion, tenderë që së bashku peshojnë mbi 765 mijë euro.
31. **“Beni Com”**, pronë e Ismet Konushevcit në vitin 2012 është angazhuar nga KEK-u për shërbime ndihmëse në largimin e djerrinës. Ismet Konushevcit është financues kronik i PDK-së, që në dy fushatat e fundit zgjedhore dha për PDK-në 3900 euro ka marrë nga MTPT-ja, me gjashtë kontrata të ndryshme 9.4 milionë euro, si dhe një sërë kontratash në institucione që drejton PDK-ja, por dhe partitë e tjera.
32. **“Besa Security”**, pronë e Fexhrije Hasanit në vitin 2012 ka fituar nga KEK-u kontratën për Ruajtja dhe sigurimi i objekteve te KEK-ut, që peshon mbi 410 mijë euro.

33. **"BLU TRADE"** që ka për pronar Muhamet Zeqirin, prej vitit 2008 ka marrë pjesë në fondet e tenderëve të mëdhenj, ku ka marrë 4 sosh, vlera e të cilëve arrin në mbi 820 mijë euro.
34. **"BMK Commerce"**, pronë e Nexhit Karimanit nga Mitrovica në vitin 2011 është kontraktuar nga KEK-u për furnizim me konop të çeliktë, tender që peshon afro 130 mijë euro.
35. **"Bojku Hidraulik"**, pronë e Gazmend Bojkut nga Peja këtë vit është kontraktuar nga KEK-u për ta furnizuar këtë korporatë me automjete e ekskavatorë, tenderë që së bashku peshojnë mbi 920 mijë euro.
36. **"Bosch"**, pronë e Rrahman Muratit nag Fushë- Kosova ka përfituar nga KEK-u në vitin 2011 tenderin "Furnizim: Furnizimi me pjesë dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve 5.5 kv" që peshon 1,037.00
37. **"Bosch"**, pronë e Abdurrahman Abdurrahmanit nga Mitrovica në vitin 2010 është shpërblyer nga KEK-u e tenderin "Furnizim me instalim te pajisjeve për nxehje dhe klimatizim ne PKU ne TC- "Kosova" B.", që peshon mbi 145 mijë euro.
38. **"Bubeari Komerc"**, pronë e Naser Guri nga Kaçaniku në vitin 2011 është shpërblyer nga KEK-u me tenderin "Furnizim me Gazra Industriale për KEK sh.a" që peshon afro 240 mijë euro.
39. **"Bul Sachen"**, kompani nga Gjermania që për person kontaktues ka Hans ÄAsenbaum, në vitin 2009 nga KEK-u është kontraktuar për punën "TEKNIKA DISKONTINUALE E TRANSPORTIMIT TË PËRAFËRSISHT 5.5 MILION M3 TË MASAVE KOMPakte TË DHEUT, NGA FUSHA E SIBOVcit JUG-PERËNDIMOR", punë që kësaj kompanie nga korporata kosovare i është paguar në vlerë prej mbi 16.1 milionë eurosh.
40. **"City Computer"**, pronë e Sabri Muratit nga Prishtina, në vitin 2012 është angazhuar nga KEK-u për ta furnizuar këtë korporatë me licenca për programet "AutoCad "dhe "Matlab". Vlera e kësaj kobtare është afro 260 mijë euro.
41. **"CmC - Ekocon"**, kompani nga Prishtina, pronë e Sylejman Behra, nga KEK-u në vitin 2010 është angazhuar për të furnizuar me plomba e siguresa, kontratë kjo që peshon mbi 100 mijë euro.
42. **"Deva Gazi"**, pronë e Lulzim Gojanit nga Gjakova në vitin 2010 është kontraktuar nga KEK-u për tenderin "Furnizim me gazra industrial", tender që peshon mbi 180 mijë euro.
43. **"Dona Impex"** , pronë e Eset Kikajt, që nga viti 2008 e deri më tash, te kategoria e tenderëve të mdhenjë ka marrë tender në vlerë mbi 1.3 milionë euro. Nga KEK-u është penalizuar për dy kontrata.
44. **"Doni"**, kompani në pronësi të Fatmir Mujës, vëllait të deputetit të PDK-së, **Shaip Muja.**, në vitin 2008 ishte angazhuar nga KEK-u për të furnizuar me shtylla të betonit, tender që peshon mbi 720 mijë euro. Fatmir Muja është aksionar edhe në këto kompani: "**Terraplan & Partners** ", "**ART ALUMINIUM** " e "**Alumil -Ko " Sh.p.k.**, ku aksionar është edhe deputeti Shaip Muja, dhe këtë kompani, sikurse kompaninë "Kosova-Green Energy", nuk e ka deklaruar në afatin e paraparë ligjor, edhe pse ajo ende është aktive në faqen e ARBK-së. Fatmir Muja është pronar edhe e përfaqëson e kompaninë "Ci-Kos", në Kosovë,, që është e regjistruar si "**CI- KOS -CRO GmbH " L.L.C** me numër të biznesit 70395218. Me këtë kompani ai në KEK kishte fituar tenderin për shitjen e mbetjeve të metalit. Kjo kompani tash është në pronësi të Fatmir Mujës, vëlla i deputetit Shaip Muja dhe numri kontaktues i kësaj kompanie është i njëjtë me kontaktin e kompanisë "**Kosova Green Energy**".

45. **“Dreni Injineriing”**, kompani nga Prishtina në pronësi të Adnan Lushtakut nga KEK-u në vitin 2008 është shpërblyer me tenderin për ndërtimin e lumit mbi urën Sitniva, tender që peshon mbi 430 mijë euro.
46. **“E-PROJECT”**, pronë e Arben Sylës nga KEK-u për periudhën 2008-2012 ka marrë tenderë të mëdhenj, vlera e të cilëve bashkë është mbi 2.1 milionë euro.
47. **“Eco Trade”**, pronë e **Mehdi Zhugolli**, e që për preson kontaktues në tenderët e përfituar në KEK e ka pos Mehdi ZHugollit, në disa tenderë, edhe Mirjeta Shllakun e Nysret Halitin, nga korporata, që nga viti 2008 e deri në vitin 2012 ka marrë tenderë që kalojnë shifrën mbi **85.4 milionë** euro.
48. **“Ekoinvest”**, pronë e Bahri Asllanit nga Prishtina në vitin 2012 nga KEK-u është shpërblyer me tenderin për furnizim me “Kablo energjetik për DPQ; Minikonkurrenc nr. 3”, që peshon mbi 480 mijë euro.
49. **“El Kontakt”**, pronë e Mehdi Begollit nga Prishtina në vitin 2009 është kontraktuar nga KEK-u për furnizim me “INVERTOR FREKUENCOR, RELE, TRANSMITTER TE RRJEDHJES DHE POZICIONER DIGJITAL”, tender ky që peshon mbi 40 mijë euro.
50. **“El- tex”**, pronë e Amir Hasanit nga Prishtina në vitin 2010 u kontraktua nga KEK-u për furnizim me pajisje elektrike, tender ky që peshon mbi 32 mijë euro.
51. “Elektra”, pronë e Valon Gashit nga Prishtina , nga KEK-u në vitin 2011 është kontraktuar për “Furnizim me material për instalimin e njehsorëve gjysmë indirekt me mundësi leximi nga distanca”, tender ky që peshon afro 190 mijë euro.
52. **“Elektro AG”**, pronë e Alush Sejdiut nga Prishtina, e që për person kontaktues ka Bujar Sejdiun, nga KEK- në vitin 2010 ka përfituar tenderin për “Furnizim me Lidhëse dhe koka kablloviqe” në vlerë prej mbi 117 mijë eurosh.
53. **“Elektro D T Projek”** që për pronar ka Nagjije Kukajn e person kontaktues te kontrata publike të fituar në KEK ka Ibrahim Kukajn, nga kjo korporatë ka fituar që nga viti 2008, vetëm te kategoria e tenderëve të mëdhenj, ka marrë tender në vlerë prej 6.7 milionë euro.
54. **“Elektroprojekt”**, kompani nga Kroacia ( nuk kemi gjetur person kontaktues në Kosovë), në vitin 2011 nga KEK-u ishte angazhuar në tenderin “PUNIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK PER MBROJTJE KUNDER ZJARRIT NE TERMOCENTRELET KOSOVA A&B”. Ky shërbim KEK-ut i ka kushtuar 167,560.00 euro.
55. **“Elektrostublla”**, kompani nga Vitia në pronësi të Marjan Ramajt, në KEK në vitin 2007 dhe 2009 ka marrë dy tenderë, vlera e të cilëve është mbi 130 mijë euro.
56. **“Elico”**, kompani në pronësi Selami Azizit nga Prishtina, në periudhën 2008-2010 ka përfituar nga KEK-u tenderë në vlerë mbi 770 mijë euro.
57. **“Eling”**, pronë e Kushtrim Nitaj nga Prishtina, në periudhën 2009-2011, nga KEK-u ka përfituar, te kategoria e tenderëve në vlerë të madhe, tender që së bashku peshojnë mbi 2010 mijë euro.
58. **“Elita”**, kompani nga Prishtina ( nuk kemi mundur t’ia gjemë pronarin në ARBK), në vitin 2007 në KEK fitoi një tender për punë. Tenderi është për “ZGJERIMI DHE PERFORCIMI I RRJETIT DISTRIBUTIV NE KEK” dhe peshon hiç më pak se mbi 3.2 milionë euro.
59. **“Elko”**, pronë e Alban , Agon , Ahmet e Mehmet Gashit nga Peja, që nga viti 2008-2011 në KEK ka marrë prokurime publike në vlerë mbi 4.4 milionë euro.
60. **“Elmont”**, pronë e Nuredin Buranit nga Prishtina nga KEK-u në vitin 2009-2010 ka marrë tender , nga kategoria e tenderëve të mëdhenj, që peshojnë afro 75 mijë euro.

61. **“Elsam”**, pronë e Sami , Eleonora , Saranda , Kadrije , Amir Musliu nga Ferizaj, që nga viti 2008-2011 në KEK ka marrë tenderë që peshojnë mbi 1.4 milionë euro.
62. **“Elteko”**, pronë e Agim Kuçit nga Suhareka, në KEK është kontraktuar një herë në vitin 2010 e njëherë këtë vit për furnizime me kablo. Vlera e këtyre dy tenderëve, që hyjnë te tenderët e mëdhenj është mbi 130 mijë euro.
63. **“Elting”**, kompani që është kontraktuar nga KEK-u për “Furnizim me Paisje komunikuese”, një tender që peshon 88,861.00 (mungojnë të dhënat për pronarin e kohën e shpërblimit)
64. **“Enbi Power”**, kompani nga Shqipëria që për person kontaktues ka Erion Mushin, në KEK, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, ka marr tenderin “PUNE SHTESE - NDËRTIME & RIPARIME TË RRJETIT TË TENSIONIT TE LARTË (TL) & TENSIONIT TË ULTË (TU) NË 26 FSHATRAT E DISTRIKTIT TE MITROVICES”. Ky tender i vitit 2009 peshon mbi 1.4 milionë euro.
65. **“ENG Co”**, kompani në pronësi të Antigona Bytyqit nga Prishtina, nga KEK-u është angazhuar në vitin 2011 në tenderin “Riparimi dhe furnizimi me pjesë i pompës së kondenzatit” që peshon mbi 147 mijë euro.
66. **“ETRA 33 Energetski Transformatorji”**, kompani nga Sllovenia (personin kontaktues nuk kemi mundur që t’a gjejmë), në KEK ka përfituar dy tenderë, nga kategoria e tenderëve të mëdhenj. Tenderët janë të viti 2009 dhe janë për furnizim me transformatorë, dhe që të dy së bashku peshojnë mbi **1.8 milionë** euro.
67. **EURO COMMERC”**, që për pronar e edhe person kontaktues ne tenderët publik të fituar në KEK e ka biznesmenin Fehmi Raçi, nga kjo korporatë prej vitit 2008 e deri tash ka marr 1.2 milionë euro tenderë, te kategoria e tenderëve të mëdhenj.
68. **“Euro Impex”**, pronë e Beqir Çerkezit nga KEK-u, te kategoria e tenderëve të mëdhenj ka marrë tenderë në vlerë mbi gjysme milioni euro, për periudhën 2008-2009. Për një tender në vlerë jo të madhe, por për mos-kryerje ose zvarritje të punëve, është penalizuar nga KEK-u në vitin 2010.
69. **“Euroditi”**, kompani nga Prishtina në pronësi të Isak Latifit, nga KEK-u në vitin 2009-2010 ka përfituar tenderë në vlerë mbi 650 mijë euro.
70. **“Eurogoma”**, kompani në pronësi të Ismet Rexhepit nga Prishtina, nga KEK-u në vitin 2011 është kontraktuar për t’iu shitur goma në vlerë prej afro 190 mijë eurosh.
71. **“Euromiti”**, kompani nga Prishtina në pronësi të Xhejlane Grainca, në vitin 2011 është angazhuara nga KEK-u për “Furnizim me Gazra Industriale”, tender që peshon afro 240 mijë euro.
72. **“Euronorma”**, kompani në pronësi të Vjollca Xhafës nga Prishtina, në vitin 2007-2010 është kontraktuar nga KEK-u për furnizim me zinxhirë. Vlera e këtyre dy tenderëve është afro 60 mijë euro.
73. **“EuroPrinty”**, për person kontaktues në tenderin “Furnizim me formular te ndryshëm te shtypur për nevoja te KEK-ut “ në vitin vitit 2011 kishte Hajriz Zabelin. Ky tender peshon 260,379.00 euro.
74. **“EX FIS shpk”**, kompani në pronësi të Isa , Remzi Muharremit nga Prishtina, në vitin 2011 është kontraktuar nga KEK-u “Furnizim me lëndë djegëse për kaldaja ( Mazut 1 % sulfur ) për TCB. “ në vlerë mbi 20 mijë euro.

75. **“Exfis”**, kompani gjermane që për person kontaktues ka Hans Eäsenbaum, është kontraktuar nga KEK-u në vitin 2009 për “TEKNIKA DISKONTINUALE E TRANSPORTIMIT TË PËRAFËRSISHT 5.5 MILIONË M3 TË MASAVE KOMPakte TË DHEUT, NGA FUSHA E SIBOVcit JUG-PERËNDIMOR”, tenderi peshon 16,104,000.00 euro.
76. **“Exsor”** kompani nga Kroacia që për person kontaktues e ka Ivica Mestrovic, në vitin 2010 ka fituar tenderin “Pjesa e 3 .Livrimi si dhe riparimi i pjesëve elektrike për shiritat transportues te Qymyrit B – 1600 mm (me çelësa ne dore ).”, që peshon mbi 4.9 milionë euro.
77. **“FAMORD INZENERING DOOEL”**, Dega në Kosovë, me pronarë Xhavit Heta e Nikola Nastevski ka marrë nga KEK, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, tenderë në vlerë afro 1 milion euro. Në vitin 2010 është penalizuar për mos përmbushje të kontratës dy kontratave, por që nuk hyjnë te kontratat e mëdha.
78. **“FEKI”**, kompani në pronësi të Mujë Krasniqit ka marrë në vitin 2008 dhe 2009 nga KEK-u nga një tender, vlera e të cilëve së bashku është mbi 240 mijë euro.
79. **“Feroda Commerce”**, pronë e Mehmet e Melos Peja nga Prishtina, që nga viti 2008-2011 në KEK ka marrë tender në vlerë mbi 350 mijë euro.
80. **“Flamtron”**, kompani nga Kroacia që për person kontaktues e ka Anto Markociq, në KEK në vitin 2010-2011 ka marrë tenderë që peshojnë mbi 2.4 milionë euro.
81. **“Fugo S A”**, kompani nga Polonia (që personin kontaktues të së cilën nuk e kemi gjetur) në vitin 2010 në KEK ka fituar tenderin “Pjesa e 1-re Livrim, montimi, parametrimi, komisionimi, testimi dhe lëshimi ne pune e stacioneve ngasëse me teleskopi”, që peshon mbi 5.4 milionë euro.
82. **“G Brioli”**, kompani nga Italia që personin kontaktes të së cilën nuk e kemi gjetur), nga KEK-u në vitin 2008 ka fituar tenderin për punë. Tenderi është emëruar si” Transportimi diskontinual i 5.5milion m3 zbules nga fusha e Sibovcit Jugperendimor”, dhe I ka kushtuar KEK-ut 17,899,750 euro.
83. **“G3-Inxhiniering”**, pronë e Shaban Hotit nga kategoria e tenderëve të mëdhenj të KEK-ut ka marr nga viti 2008 deri më tani tenderë në vlerë mbi 3.8 milionë euro.
84. **“Ganz meter”**, kompani nga Hungaria, që për person kontaktues e ka Biro Istvan, në vitin 2010 ka fituar nga KEK-u tenderin “FURNIZIMI DHE LIFERIMI I NJEHSCOREVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET”. Vlera e këtij tenderi ishte mbi 1.3 milionë euro.
85. **“Ganz Meter Company”**, po ashtu nga Hungaria, por që tash ka për person kontaktues njeriun me emrin “Mehmet Gashi” (edhe kompania “Elko” ka pronarin e tretë dhe njëherit person kontaktues me emrin Mehmet Gashi nga Peja). Edhe kjo kompani, sikurse paraprakja në vitin 2010, veç kjo tash në vitin 2011 ka fituar tenderin me titull “ FURNIZIMI DHE LIFERIMI I NJEHSCOREVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET SHTEPIAK per KEK.SHA”. Edhe ky tender është pothuajse i vlefshëm sa parapraku dhe saktë KEK-ut i ka kushtuar 1,268,100 euro.
86. **“GC Metal”**, pronë e Lulavere, Fidaim , Fatmir e Florin Imerit nga Janjeva në vitin ka fituar nga KEK-u tenderin “Lot 6 : Furnizim me pllaka rrëshqitëse” që peshon mbi 55 mijë euro.
87. **“Gema Plast – KM”** , kompani nga Maqedonia e që për person kontaktues në Kosovë ka Sadat Cakollin, në vitin 2009 në KEK ka fituar tenderin “Ndërtimi i linjës se re te gypit për furnizim me ujë te rëndomtë për TC-B nga Kanali Iber – Lepenc”, që KEK-ut i ka kushtuar afro 1.3 milionë euro.
88. **“Geomineral”**, kompani në pronësi të Hajati Banjica , Enver Berisha e Sadat Cakolli ( I fundit është person kontaktues edhe te **“Gema Plast – KM”** , kompani nga Maqedonia), ka marrë në KEK nga viti 2009-2011 tenderë në vlerë 1.6 milionë euro, duke llogaritur këtu edhe tenderin “Ndërtimi i linjës se re te gypit për furnizim me ujë te rëndomtë për TC-B nga Kanali Iber – Lepenc”, që e kanë në konzorcium me **“Gema Plast – KM”** nga Maqedonia.

89. Kompania **“Gerguri”** ( pronarët e së cilës nuk l kemi gjetur), në vitin 2008, në konzorcium me **“G Brioli”**, kompani nga Italia ka marrë pjesë në tenderin “Transportimi diskontinual i 5.5 milionë m<sup>3</sup> zbulës nga fusha e Sibovcit Jugperendimor”, që peshon mbi 17.8 milionë euro.
90. **“GHM Company”**, kompani në pronësi të Jeton Hetës nga Drenasi nga KEK-u në vitin 2011 ka përfituar tenderin “Furnizim me llamarine, shufra, profile LOT 1 Furnizim me llamarina”, që peshon mbi 270 mijë euro.
91. **“Gosa Fom”**, kompani nga Serbia (që nuk kemi mundur t’ia gjemë personin kontaktues në Kosovë), në konzorcium me kompaninë **“Exsor”** kompani nga Kroacia që për person kontaktues e ka Ivica Mestrovic, në vitin 2010 ka fituar tenderin “Pjesa e 3 .Livrimi si dhe riparimi i pjesëve elektrike për shiritat transportues te Qymyrit B – 1600 mm (me çelësa ne dore ).”, që peshon mbi **4.9 milionë** euro.
92. **“GRAMOZI”**, kompani që për pronar ka Ymer Çerkinin, nga KEK-, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, prej vitit 2007-2010 ka fituar tenderë në vlerë prej 467 mijë euros.
93. **“Graniti”** nga Suhareka, të cilit a kemi gjetur veç personat kontaktues të tenderëve të fituar në KEK (Bajram e Jakup Lumi, pa mundur ta identifikonim në ARBK saktë se cili Granit është), nga korporata ka fituar tenderë në vlerë mbi 100 mijë euro, dhe këtë në vitin 2008-2011.
94. **“Grichtng”**, kompani nga Zvicra, në konzorcium me një kompani tjetër ka fituar në vitin 2007 tenderin “Dizajnimi, Ndërtimi dhe Komisionimi i Objekteve Elektroenergjetike në RAHOVEC”, që peshon 5,773,905. Për këtë kompani nuk kemi gjetur person kontaktues në Kosovë.
95. **“H&S Com”**, pronë e Haki Zeqirit nga Prishtina në vitin 2012 nga KEK –u ka marrë tender në vlerë prej mbi 207 mijë eurosh.
96. **“Hamon Environmental GmbH”**, kompani e Gjermanisë që për person kontaktues në Kosovë e ka Alban Shoshin, si pjesë e konzorciumeve në vitin 2011 ka qenë pjesë e tenderëve multi-milionësh. Kjo kompani mori hise në tenderin “Furnizim me rekonstruktim te ell.filtrave ne bllokun A5, përfshirë projektimin, rekonstruktimin dhe implementimin konform kërkesave te standardeve Evropiane LCPD 2001 / 80 / EC per emisione te koncentrimit te pluhurit ne atmosferes < 50 mg / Nm<sup>3</sup>”, që peshon **8,903,000** dhe hise po ashtu mori edhe në tenderin "FURNIZIM ME FILTRA ELEKTRIK PER BLOQET A3,A4,A5 NE TC- “Kosova” A, PERFSHIRE PROJEKTIMIN, REKONSTRUIMIN DHE IMPLEMENTIMIN KONFORM KERKESAVE TE STANDARDEVE EVROPIANE LCPD ( 2001 / 80 / EC ) PER EMISIONE TE KONCENTRIMIT TE PLUHURIT NE ATMOSFERE < 50 mg / Nm<sup>3</sup>. Lot 2: Furnizim me rekonstruktim te ell.filtrave ne bllokun A3 dhe A4, përfshirë projektimin, rekonstruktimin dhe implementimin konform kërkesave te standardeve Evropiane LCPD 2001 / 80 / EC për emisione të koncentrimit të pluhurit në atmosferë < 50 mg / Nm<sup>3</sup> .”, që peshon **16,994,000**.
97. **“HB Project”**, pronë e Hasan Bashotës në vitin 2010 nga KEK-u ka marrë një tender që peshon afro 400 mijë euro.
98. **“Hekurani”**, kompani në pronësi të biznesmenit Naser Gashi nga Ferizaj, në KEK që nga viti 2008-2011 ka marrë një sër tenderësh të kategorizuar si tenderë me vlerë të madhe, që së bashku peshojnë mbi **1.4 milionë** euro.
99. **“Hoting”**, kompani në pronësi të Murat Hotit nga Malisheva në vitin 2008 ka marrë nga KEK-u një tender në vlerë prej 172 mijë eurosh.
100. **“Hyundai Heavy Industries”**, kompani nga Sofie e Greqisë , që për person të autorizuar në tenderët e KEK-ut ka Bekim Halitin (“Ballkan Petrol” po ashtu pronë e Bekim Halitit nga Ferizaj që nga KEK-u prej viti 2008-2012 ka përfituar tenderë në vlerë mbi 5.7 milionë euro. KEK nga kjo kompani është furnizuar prej vajrave industrial, te transformatorët e deri te motorët për pompa), në konzorcium me kompani të tjera ka përfituar në vitin 2009 tenderin “TRANSFORMATOR PER SHPENZIME VETJAKE (BT)”, që peshon 598,700 dhe në vitin

2011 tenderin "Furnizim me TRANSFORMATOR 240MVA; 15.75 / 230KV Yd5, ftohja N", që peshon **1,649,601** euro.

101. "I & A sh.p.k", pronë e **Bejtush Zhugolli** e Sevdije Hajrizit, kompani që hynë në grupin e kompanive të familjes Zhugolli, ka marrë nga KEK tenderë në vlerë prej **4.1 milionë** eurosh ( te kategoria e tenderëve të mëdhenj). Këta tenderë i kanë marrë vetëm në vitin 2010-2011. Derisa **në vitin 2010 u penalizua** për mos përmbushje të dy kontratave, por megjithëkëtë, në vitin 2011 është shpërblyer edhe me tri kontrata të tjera, vlera e të cilave është mbi 1.5 milionë euro.
102. **Ndërmarrja Shoqërore "Iber Lepenc"**, që aktualisht drejtohet nga Hajdar Beqa është kontraktuar në vitin 2011 nga KEK-u për "Furnizim me ujë të papërpunuar për dep. TC-A dhe TC-B", një tender që KEK-ut i ka kushtuar 700 mijë euro.
103. "IMK 14 Oktobar" nga Serbia ,që nuk i kemi gjetur një person kontaktues në Kosovë, në konzorcium me "ECO-TRADE", kompani në pronësi të familjesh **Zhugolli, "INTERING"** në pronësi të familjes **Shoshi** dhe kompanisë "Magdeburger ForderantagenUnd Baurnaschinen GmbH , ""LLOTI B: RIPARIMI MAKINERIK DHE ELEKTRIK I SISTEMIT TË SHIRITIT TRANSPORTUES 1,800 mm". Për këtë tender Express ka raportuar se ka dështuar, ani pse tenderi kushton 49,983,528 euro dhe është dhënë në vitin 2008.
104. "INA", kompani nga Shqipëria- Tiranë, që për person kontaktues ka Ferdinand Çausi, ka fituar në KEK në vitin 2010 tenderin "Dizajnimi dhe ndërtimi i TS (110)/10(20) kV Parku i Biznesit Drenas (punë ndërtimor" që peshon mbi 460 mijë euro.
105. "Info Com", kompani nga Mitrovica, pronë e Burim Haxha, në vitin 2012 është angazhuar për furnizim me tonerë nga KEK-u, një kontratë që peshon 715.00
106. "Install Engineering", prone e Ahmet Osmani, Ibrahim Jakupaj, Ridvan Shabanit nga Prishtina, në KEK në periudhën 2007-2010 ka marrë tenderë në vlerë mbi **2.5 milionë** euro.
107. **Ndërmarrja Shoqërore "Instituti Inkos"** në vitin 2011 nga KEK-u ka përfituar një tender të vlefshëm mbi 780 mijë euro, për " BLERJA E SHËRBIMEVE PER HULUMTIME, SHQYRTIME, ANALIZA DHE PROJEKTIME".
108. "Inter Adrija", pronë e Agim Asllanit nga Prishtina, ka përfituar tenderin "Projekti i VIDEO VËZHGIMIT ne KEK sh.a", që peshon mbi 8,389 euro.
109. "Inter Trading", pronë e Xhafer Halilit nga Prishtina këtë vit ka fituar tenderin për furnizim me kablo elektrike që peshon 458,366 euro.
110. "Intering", pronë e Xhevdet e **Arben Shoshit** nga Prishtina, që nga viti 2008 e deri në vitin 2012, duke qenë edhe pjesë e konzorciumeve, është përfituese e tenderëve në vlerë afro 38 mijë euro. Kjo kompani e familjes Shoshi ka marrë punë, furnizime e shërbime.
111. "Intering GmbH", kompani nga Gjermania , që në Kosovë, sikurse kompania "Interging" është e regjistruar në emër të biznesmenëve nga familja **Shoshi**, kjo vetëm në emër të Gani Shoshit, e që për person kontaktues ka Alban Shoshin ka marrë pjesë në dy tenderë të mëdhenj si konzorcium. Si konzorcium kjo kompani ka marrë pjesë në dy tenderë në vitin 2011, pesha e të cilëve është mbi **25.8 milionë** euro.
112. "Inziniering", kompani nga Maqedonia që për person kontaktues në Kosovë ka Sandre Trpovski, në vitin 2011 ka fituar tenderin "ZGJERIMI I TRAFOSTACIONIT 110/35 KV PRIZRENI 1", që peshon mbi 680 mijë euro.
113. "Iskraemeco", kompani nga Kranja e **Slovenisë**, e cila si person kontaktues në Kosovë herë e ka pasur Dieter Brunner e herë Bahha Eldin Abdallah Mohamed Baiomy, nga KEK-u që nga viti 2009-2012 ka marrë mbi **5.9 milionë** euro.
114. "Karposh", kompani nga Maqedonia (përfaqësuesin e të cilës në Kosovë nuk e kemi gjetur), mori pjesë në konzorcium me një kompani tjetër në tenderin "Furnizim me shtylla Betoni", që peshon mbi 720 mijë euro dhe është dhënë në vitin 2008.



115. **“Kastrioti”**, nga Prishtina, që për person kontaktues ka **Hans Jurgen Asenbaum**, ka marrë pjesë, si pjesë e konzorciumit, në tenderin “TEKNIKA DISKONTINUALE E TRANSPORTIMIT TË PËRAFËRSISHT 5.5 MILION M3 TË MASAVE KOMPAKTE TË DHEUT, NGA FUSHA E SIBOVCI JUG-PERËNDIMOR”, që peshon **16,104,000**. Në këtë tender janë në konzorcium edhe kompanitë “Bul Sachen” e “Exfis”, të dyja kompani gjermane që po ashtu për person kontaktues kanë **Hans Jurgen Asenbaum**.
116. **“Kolubara Metal”**, kompani nga **Serbia** (që personin kontaktues të së cilës nuk e kemi gjetur), në vitin 2010, si pjesë e një konzorciumit me kompani të tjera ka marrë pjesë nga tenderi “Pjesa e 2-re Livrimi dhe mbikëqyrja e pajisje dhe material për pjesën mekanike të shiritave transportues të Qymyrit B – 1600 mm).”, që peshon mbi 4.8 milionë euro.
117. **“Kombinimi”**, kompani në pronësi të Kadrije Krasniqi e Adnan Krasniqi që për person kontaktues ka Hazir Gashin, në vitin 2008 nga KEK-u ka përfituar tenderin “Lot 6 – Furnizim me pjesë rezerveë për mekanizimin Iveco”, tender që vlen 285 mijë euro.
118. **“Komtel Projekt Engineering”**, kompani në pronësi të **Vegim Gashit**, kandidat i AKR-së për kryetar të Prishtinës në vitin 2009, dhe që kur u krijua kishte si bashkaksionar edhe **Fadil Ismajlin**, atëherë njëri nga menaxherët e KEK-ut, tash **kryeshef i KOSTT-it**, nga KEK-u, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, nga KEK ka përfituar tre tenderë për furnizime që peshojnë **mbi 1 milion euro**. Tenderët janë dy të viti 2009 dhe një i vitit 2011.
119. **“Koncar Power Transformers”**, kompani nga Kroacia (personin kontaktues të së cilës nuk e kemi gjetur), nga KEK-u ka përfituar tenderin “FURNIZIM ME TRANSFORMATOR RRITES TE FUQISE 240MVA, 15.75/230 KV PER GJENERATOR”. Ky tender kësaj kompanie i është dhënë në vitin 2009 dhe peshon **2,070,000**.
120. **“Koncar vin project”**, po ashtu kompani nga Kroacia (personin kontaktues të së cilës nuk e kemi gjetur), si pjesë e një konzorciumi në vitin 2009 ka përfituar nga tenderi i KEK-ut: “FURNIZIM ME MBIKQYRJE DHE MBROJTJE NGA KORROZIONI TE PAISJEVE KRYESORE XEHTARE PER MIHJEN “Sibovci” Jug-Perendimor”, tender që peshon **2,087,405**.
121. Në të dhënat e KEK-ut për tenderë paraqitet edhe një kompani tjetër nga Kroacia me emrin zyrtar “Konqar”, e që i është gjetur vetëm emri i personit kontaktues, **Radoslav Stoilkjovic**. Edhe kjo në vitin 2008 është angazhuar nga KEK-u për “FURNIZIM ME TRANSFORMATOR KRYESOR 400 MVA 24 KV /400 KV (2AT) PER TC KOSOVA B”, tender që peshon **4,051,000 euro**.
122. **“Kopex”**, kompani nga Polonia që për person kontaktues ka Bozinov Eolna, në vitin 2010, duke qenë pjesë e një konzorciumi ka marrë tenderin “Furnizim me Material për pajisje makinerike për teleskopi”, që peshon **417,702 euro**.
123. **“Kopex – Famago”**, po ashtu kompani nga Polonia, për person kontaktues në Kosovë ka Daëid Siluta. Kjo kompani, si pjesë e një konzorciumi, ka marrë nga KEK-un në vitin 2011 tenderin “PUNIMI KOMPLET ME ÇELËSA NË DORË I STACIONEVE KTHYESE TË REJA B=1800mm DHE B=1600mm LOT 2. PUNIMI KOMPLET ME ÇELËSA NË DORË I STACIONEVE KTHYESE TË REJA B=1600mm”, tender që peshon **327,201 euro**.
124. **“Kos- Ing”**, kompani nga Prishtina në pronësi të biznesmenit Faik Halili, në vitin 2011 ka marrë nga KEK-u tenderin “Punë: Punë ndërtimore dhe elektrike në TS”, që peshon afro **140 mijë euro**.
125. **“Kos Steel”**, kompani në pronësi Vahedin Grajqevcit nga Obiliqi, nga KEK-u në vitin 2012 ka marrë tenderin “Shërbime ndihmese në largimin e djerrinës ( sipas nevojës )”, që peshon **180,960 euro**. Kjo kompani ishte në garë edhe më tenderin për shitjen e skrapit në KEK, tender që e fitoi kompania “Ci-KOS”, pronë e vëllait të deputetit **Shaip Muja, Fatmirit**.
126. **“KWE”**, pronë e Arben Jasharit ka marrë nga KEK-u, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, tenderë në vlerë prej afro **630 mijë eurosh**. Kjo vetëm për periudhën 2007-2010. Pas

kësaj periudhe ajo, nga hulumtimi i "Preportr" nuk është gjetur te tenderët e mëdhenj, por në raportin penaltive të KEK-ut kundër kompanive që nuk i kanë kryer punët sipas kontratës, ajo figuron që të jetë ndëshkuar 4 herë vetëm në vitin 2010.

127. **"L&R Motors"**, pronë e Abdullah Berishës nga Fushë Kosova në vitin 2011 ka fituar nga KEK-u tenderin "SERVISIMI DHE FURNIZIMI ME PJESE PER AUTOMJETE LANDROVER" që peshon mbi 90 mijë euro.
128. **"Labi"**, kompani nga Prishtina (pronarin e të cilës nuk kemi mundur ta identifikojmë në ARBK), nga KEK-u në vitin 2007 ka përfituar dy tenderë për punë, të cilët së bashku peshojnë mbi **1 milion euro**.
129. **"Land Gyr"**, kompani nga Prishtina (pronarin e të cilës nuk kemi mundur ta identifikojmë në ARBK), nga KEK-u në vitin 2009, duke qenë pjesë e konzorciumit me disa kompani të tjera ka përfituar nga tenderin "Furnizim me njëzor tre-fazor, gjysem indirect per konsumatorët komercial", që peshon afro 500 mijë euro.
130. **"Landis + Gyr d.o.o"**, kompani nga Sllovenia, që për person kontaktues ka Primož Škofic, në vitin 2011 ka marrë nga KEK-u tenderin "FURNIZIMI DHE LIFERIMI I NJEHSCOREVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET SHTEPIAK per KEK.SHA", që peshon mbi 240 mijë euro.
131. **"Liebherr Export"**, kompani nga Zvicra, (që nuk kemi mundur t'ia gjejmë personin kontaktues në Kosovë), në vitin 2008-2009 ka marrë nga KEK-u tenderë për furnizim në vlerë afro **1.6 milionë euro**.
132. "Linda", që për person kontaktues e ka Milaim Berishën nga Ferizaj, në vitin 2010 ka marrë nga KEK-u tenderin "Renovimi i rrugës Dardhishtë-Mirash", që peshon mbi 27 mijë euro.
133. **"Lorentajn Invest in Doel"**, kompani nga Maqedonia që për person kontaktues ka Ričard Miloševski, në vitin 2010 ka marrë nga KEK-u 2 tenderë për furnizime në vlerë afro 120 mijë euro.
134. **"LTG"**, pronë e Faton Gergurit nga Prishtina në vitin 2010 nga KEK-u është angazhuar për të furnizuar me pjesë rezervë, në një tender që peshon mbi 80 mijë euro.
135. **"Luca Bau"**, kompani nga Fushë Kosova, pronë e Arben Ejupit, nga KEK-u në vitin 2009-2010 ka marrë tenderë në vlerë afro 440 mijë euro.
136. **"Magdeburger ForderantagenUnd Baurnaschinen GmbH"**, pronë e Faruk Ashimoviq, Bernd Udo Petermann nga Gjermania, në vitin 2008, si pjesë e një konzorciumi fitoi tenderin "LLOTI C: RIPARIMI MAKINERIK DHE ELEKTRIK I PALOSËSIT A2RSB 5200.55 PËRFSHIRË EDHE LIFERIMIN E TAMBURIT TË RI TË KABLLO", që peshon **22,157,385 euro**.
137. **"Mahagoni"**, pronë e Isa Hajdinit nga Prishtina në vitin 2009 u angazhua nga KEK-u "Furnizim me Enterier dhe punimi i paravaneve për DFU", tender që peshon mbi 160 mijë euro.
138. **"Mega"**, kompani nga Gjilani, pronë e Mejdi e Florina Zymberit, që nga viti 2008-2011 nga KEK- ka marrë tenderë për furnizime te ndryshme në vlerë mbi 1 milion euro.
139. **"Megi Bau"**, kompani në pronësi të familjes së deputetit të LDK-së, **Hashim Deshishku**, që në ARBK është e regjistruar në emër të Driton e Fahri Deshishkut në vitin 2008, ishte angazhuar nga KEK-u për largimin e djerrinës, punë që KEK-ut i kushtoi mbi **1.3 milionë euro**.
140. **"Metal doel Kavadarci"**, kompani nga Maqedonia, (personin kontaktues të së cilës nuk kemi mundur ta gjejmë), në vitin 2011 është kontraktuar nga KEK-u për "Furnizim me rrula,

xhunga hidrodinamik dhe pastrues shiritave për DGJE dhe DPQ”, tender që peshon mbi 17 mijë euro.

141. **“Mikroingjineri”**, kompani nga Prishtina (pronarin e të cilës nuk kemi mundur ta gjejmë në ARBK), si pjesë e një konzorciumi në vitin 2007 ka marrë hise nga tenderi “Dizajnimi , lifrimi , montimi dhe komisionimi i Kaldajes se re 50t/h avull”, tender që peshon **1,077,020 euro**.
142. **“Mont Engineering”** pronë e Mehmet Hasanit nga KEK-u, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, ka marrë mbi 1 milion e 45 mijë euro tenderë. Në vitin 2010 është penalizuar për mos përmbushje të 3 kontratave, por kjo nuk e ka penguar që në vitin 2011 të shpërblehet edhe me një kontratë të natyrës së njëjtë për të cilën është dënuar, pra kontratë për furnizim me pajisje elektrike. Kontrata e fundit, pas dënimit, peshon afro 300 mijë euro.
143. **“Monten”**, kompani nga Prishtina në pronësi të Nexhmi Kastratit, që në disa tenderë, pos pronarit, ka për person kontaktues edhe Mladen Rakic, nga KEK-u për vitet 2009-2011 ka marrë një sërë tenderësh. Kjo kompani edhe si kompani e vetme, por edhe pjesë e konzorciumeve, ka marrë tenderë që peshojnë **mbi 16.5 milionë euro**.
144. **“Monting”**, kompani nga Prishtina, pronë e Sami Ahmetit që nga viti 2007-2010 në KEK përfiton te kategoria e tenderëve të mëdhenj vetëm si kompani në konzorcium me kompanitë e tjera. Kështu, **“Monting”** për këto katër vite, si kontraktorë i KEK-ut për punë të ndryshme ka marrë hise në tenderë që së bashku peshojnë **mbi 1.57 milionë euro**.
145. **“Monting Energjetika”**, kompani nga Prishtina në pronësi të Shefqet Rrahmanit, në vitin 2011 ka marrë nga KEK-u tenderin “Furnizim me pajisje per PKU”, që peshon afro 70 mijë euro.
146. **“MONT KOMERCE”**, pronë e Genc Vezvesja ka marrë nga KEK-u, te tenderët e mëdhenj, tenderë në vlerë mbi 6.1 milionë euro prej vitit 2007-2010. Në vitin 2010 kjo kompani është penalizuar nga KEK-u për mos kryere sipas kushteve të kontratës: “Fur. Me perqes AL – FE”.
147. **“MTA 2”**, pronë e Fatmir Malokut e Bekim Goçit në vitin 2007 ka marrë një tender për furnizim me litar të KEK-ut, tender që peshon 13 mijë euro.
148. **“N.T. KWE & RGI GmbH”**, kompani nga Prishtina për furnizim me instalime në vitin 2011 ka marrë një tender prej afro 280 mijë eurosh.
149. **“NAT”**, kompani e Nazim Sopit nga Prishtina në vitin 2011 nga KEK-u ka marrë tre tenderë për furnizime në vlerë prej afro 50 mijë eurosh.
150. **“Ndërtimtari”**, pronë e Qerim Braha, edhe plotë persona të tjerë, në KEK, edhe si e vetme por edhe me konzorcium, nga tenderët e mëdhenj, ka marrë tenderë në vlerë prej afro 580 mijë eurosh vetëm për periudhën 2010-2012.
151. Kompania e **artistit Blerim Gjoci**, **“Neë Film”** në konzorcium me **“The Group”**, pronë e Bekim Selës, është kontraktuar nga KEK-u në vitin 2011 për punën ‘Fushata edukuese sensibilizuese për publikun’, kontratë që peshon **mbi 660 mijë euro**.
152. **“New Lepenci”**, kompani nga Kaçanik me pronar Qenan Idrizi , Ali Vila , Bejtulla Ademi, nga KEK-u në periudhën 2009-2011 është kontraktuar për furnizime në vlerë mbi 680 mijë euro.
153. **“Newko Ballkan”**, kompani e privatizuar, që tash për pronar ka Ozer Konveyor Band Turizm Sanayi Ve TIC. e Murat Shimsheku , kurse në tenderët e fituar në KEK ka paraqitur si person kontaktues Hajriz Sukën e Muhamet Shalën, nga korporata për katër vite , 2008-2012 ka marrë tenderë në vlerë mbi **6.7 milionë eurosh**. Të gjithë tenderët janë për furnizim me shiritë gome.

154. **“Ngjyrosja”**, kompani nga Skënderaj në pronësi të **Sadik Lushtakut**, në KEK në vitin **2010 ka marrë një tender prej 580 mijë eurosh për “Mbrotjtjen e antikorodive për eskavatoret E9M dhe E10M”**.
155. **“Nilos - Nilos GmbH & Co. KG”**, që për pronar ka “Nilos GmbH & Co” e person të autorizuar Nazim Gashin nga Prishtina, nga kategoria e tenderëve të mëdhenj të KEK-ut ka marrë që nga viti 2007-2011 tenderë në vlerë prej mbi 1.7 milionë eurosh. Në vitin 2010 është penalizuar për mos realizimin e një kontrate me KEK-un, por kjo nuk e ka penguar që në vitin 2011 të marrë edhe katër tenderë, vlera e përbashkët e të cilëve kalon mbi 1 milionë euro.
156. **“Office1Kosova”**, pronë e Asaf Bujarit nga Prizreni në vitin 2011 ka marrë në KEK tenderin **“FURNIZIM ME MATERIAL TE ZYRES PER KEK Sha”**, që peshon 174 mijë euro.
157. **“OVE Group”**, që aktualisht për pronarë ka **Visar Banjica e Njomza Rrecaj**, në KEK në vitin 2011 ka marrë tenderin **“Furnizim me rula”** që peshon veç 6,886 euro. Por, kjo kompani është kompania që u ankua kundër KEK-ut për tenderin e datës 14.03.2012 për **‘Shitja e Thëngjillit’** që në këtë datë i ishte dhënë konzorciumit **“NTN GERGURI – ZYSKENTRANS”**. Ishte ankesa e **“OVE Group”** në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (**OSHP**) që anuloi këtë tender. Tenderi është rishpallë, por më 2 korrik 2012 është anuluar përsëri, tash nga vetë KEK-u, me arsyetimin se mungojnë kompanitë e përgjegjshme. Kjo kompani është e lidhur me bizneset e familjes së kryeministrit **Hashim Thaçi**. Kështu, **“OVE Group”**, që deri në shtator të vitit 2011 kishte emrin **“BOXON”**, si aksionarë kishte edhe biznesmenin nga Drenasi, **Milaim Cakiqi**. E Cakiqi është biznesmen që në kompani të ndryshme është bashkë-aksionar më vëllain e vogël të kryeministrit Thaçi, **Blerimin**. Cakiqi e Thaçi janë aksionarë bashkë në kompaninë N.T.P **“Almakos”**, kurse Cakiqi me kusherinj e vëllezër ka edhe kompanitë **“Liria F.C-2” Sh.p.k.** kompaninë **“Ndërmarrja e re Metamb” Sh.p.k** ka. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm pati konstatuar se ka pasur manipulime në një proces privatizimi të ndërmarrjes Kosova Elektro ku fitues ishte shpallur më 19 nëntor 2008 kompania Liria FC pronë e Fazli Cakiqit, i afërm i Milaim Cakiqit. “Në kontratën Kosova Elektro, ne kemi vërejtur se gjatë procesit të privatizimit AKP-ja ka manipuluar me sipërfaqen e lokalit të privatizuar. Ne kemi vërejtur parregullsi dhe transparencë të pamjaftueshme në procesin e privatizimit, si rezultat i një konkurrence të padrejtë ndërmjet ofertuesve,” pati konstatuar Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo kompani pati blerë këtë ndërmarrje për 1 milion e 50 mijë euro. Së fundi është publikuar edhe në vizitën e famshme të Kryeministrit Thaçi në restorantin **“Balkanika”** në Shkup, ai ishte vozitur me MBË X 5-shin e Milaim Cakiqit. “TV A1” nga Maqedonia kishte raportuar në shkurt të vitit 2009 se kreu i ekzekutivit në Kosovë kishte qëndruar në këtë restorant dhe video-raporti ishte bërë shpejt i famshëm në internet. Thaçi atëherë i kishte thënë televizionit maqedonas se ishte në qëndrim privat dhe në të njëjtën kohë zëdhënësi i atëhershëm i Qeverisë, Memli Krasniqi, kishte thënë se kreu i ekzekutivit atë pasdite e kishte pasur të lirë. Thaçi nuk e ka sqaruar ndonjëherë më tej këtë vizitë publikisht. Por, vetura me të cilën Thaçi kishte shkuar në Maqedoni nuk ishte as pronë shtetërore e as e tij.
158. **“P & I”**, kompani nga Prishtina, (pronarin e të cilës nuk e kemi gjetur në ARBK), në konzorcium me kompaninë **“Mikroingjineri”**, kompani nga Prishtina (pronarin e të cilës nuk kemi mundur ta gjejmë në ARBK), në vitin 2007 kanë marrë hise nga tenderi **“Dizajnimi, lifrimi montimi dhe komisionimi i Kaldajes së re 50t/h avull”**, tender që **peshon 1,077,020 euro**.
159. **“Palfinger Kran”**, kompani nga Kroacia që për person kontaktues ka Andrej Rustja, ishte kontraktuar nga KEK-u në vitin 2010 për furnizim me një automjet transporti me vinç, që KEK-ut i kushtoi mbi 200 mijë euro
160. **“PBC KOSOVA”**, pronë e Gazmend Selmanit për dy vite në KEK, 2008-2010 ka marrë te kategoria e tenderëve të mëdhenj, tenderë në vlerë prej mbi 2.6 milionë eurosh. Nga KEK-u kjo kompani për mos përmbushje të kontratës ishte penalizuar një herë në vitin 2010, kurse për

dyshime se ka falsifikuar dokumente për tenderin për instalimin e sistemit monitorues në makinat qeveritare të shpallur nga Ministria e Administratës Publike, Kreu i Antikorrupsionit, Hasan Preteni kishte deklaruar se lëndën e kësaj kompanie do ta dërgonte në Prokurori. Nuk është publikuar më ndonjë informacion se çka është bërë me këtë kompani, derisa ajo në faqen e saj zyrtare në internet e ka listuar si klientë institucione si: Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ministritë e Qeverisë së Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës, Zyra e Auditorit Gjeneral, Komisioni Qendror Zgjedhor, KEK, PTK, Qendra për Inteligjencë Financiare, Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale, Oda e Avokatëve të Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Insig sh.a., Ndërmarrja Publike Banesore.

161. **“Pentkos”**, kompani në pronësi të Edona Lekaj nag Prishtina dhe të Karl Jurgen Kaas, në vitin 2011 është angazhuar nga KEK-u për shërbimi **“PASTRIMI KONTIUNAL I SIPERFAQEVE NGROHESE TE KALDAJES ME DOZIMIN E ADITIVEVE KIMIK NE SHIRITA TRASNPORTUES TE QYMYRIT NE TC KOSOVA B GJATE PUNES NORMAL TE BLOKUT”**, shërbim që i kushtoi KEK-ut afro 230 mijë euro.
162. **“Perparimi”**, kompani në pronësi të biznesmenit nga Drenasi, Skender Bogiqi, sipas gjetjeve të Preportr, në vitin 2008 ka marrë dy tenderë, të kategorizuar si tenderë të mëdhenj, të cilët së bashku peshojnë mbi 430 mijë euro.
163. **“Plus”**, pronë e Kemajl Zeqirit nga Ferizaj, në KEK për vitet 2008-2010 ka marrë katër tenderë për furnizime të cilët së bashku peshojnë mbi 200 mijë euro.
164. **“Polog kompani”**, kompani nag Tetova e Maqedonisë, që për pronar ka **Visar Banjicën**, që njëherit është edhe pronar i **“OVE Group”**, në vitin 2009 në KEK ka marrë një tender për furnizim me pllomba dhe një tjetër për furnizim me transformatorë. Vlera e përbashkët e këtyre dy tenderëve është mbi 140 mijë euro.
165. **“Prebreza”**, kompani nga Fushë Kosova, në pronësi të Ismet Prebrezës, në vitin 2008 u kontraktua nga KEK-u për furnizim me "Paisje elektrike per shirita transportues ne Sektorin e Sitnicës, tender që peshon mbi 240 mijë euro.
166. **“Prima Commerce”**, pronë e Fahri Bajrami e Perihan Bajrami në vitin 2009-2010 në KEK ka marrë tre tenderë për furnizime të cilët kalojnë vlerën mbi 420 mijë euro.
167. **“Pro – Integris”**, kompani nga Kroacia që për person kontaktues ka Mladen Perkov në vitin 2010 në KEK ka marrë tenderin **“Furnizim dhe LIFERIMI –MONTIMI I MBROJTJEVE PER GJENERATOR –A3 A5”**, që peshon 217,036 euro.
168. **“Pro Trade”**, kompani në pronësi të **Syzana Zymberi** e që për person kontaktues ka **Valon Zymberin**, në vitin 2011 në KEK ka marrë tenderin **“Furnizim me material izolues për DPQ”** që peshon 73,742 euro . **“Pro Trade”** është pjesë e një dyshimi për kurdisje të tenderit **“Furnizimi me automjete për zjarrfikës”** me Nr. i prokurimit 616 08 053 111 të Komunës së Prishtinës, që edhe sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), kompania që lidhi kontratë me Komunën e Prishtinës **e mashtroi** këtë të fundit duke i ofruar makina të cilat nuk ishin me karakteristikat e deklaruara në Dogana. Më vonë, **“Prishtina Insight”** në një hulumtim gjeti që krejt tenderi ishte i kurdisur pasi që në këtë tender kishin ofertuar katër kompani i të regjistruara në të njëjtën ditë dhe disa me zyra e kontakte të njëjta. Kompanitë në garë ishin : **“All Zone”, “Fast NP”, “Ideal Solutions” dhe “Pro Trade”** që u shpërblye me tender. Që të katërtat ishin regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 27 janar 2009, vit ky kur

edhe **“Pro Trade”** u shpërblye me tenderin në fjalë, kurse tre nga kompanitë kanë qenë të renditura me adresa të ngjashme në lagjen Dardania të Prishtinës, kurse edhe telefon fiks i shënuar për **“All Zone”** në dokumentacionin e ofertës për tenderin e furnizimit me automjete të zjarrfikësve ishte njëjtë me atë të shënuar për **“Ideal Solutions”** tek një njoftim për dhënie të një kontrate tenderi tjetër. Megjithëkëtë, më 05/10/2011, Komuna e Prishtinës nëpërmjet njoftimit për dhënie të kontratës me numër të Nr. i prokurimit 616 11 176 511 shpërblen kompaninë **“Allzone&ABC”** me tenderin **“Ndërtimi i Sheshit të Pavarësisë “Ibrahim Rugova”** për një kontratë që peshon **4.365.714,70 €**. Së fundi këtij biznesmeni, në konzorcium **“All Zone” & “Gërguri” & “Zysken Trans”**, i është dhënë hise edhe në tenderin **“Ndërtimi i sheshit “Zahir Pajaziti”, që peshon mbi 4.7 milionë euro.**

169. **“Profitech”**, pronë e Basri Asllanit, ka marrë nga KEK në vitin 2010, në kategorinë e tenderëve të mëdhenj, një tender prej afro 490 mijë eurosh. Në po këtë vit, për mos përmbushje të dy kontratave të dala nga tenderë në vlera më të vogla, **“Profitech”**, është dënua nga KEK-u me nga 10 % të vlerës së kontratës.
170. **“Prompt”**, pronë e Burim Tolajt nga Prishtina në KEK në vitin 2010 ka fituar tenderin **“MIREMBAJTJA E INFRASTRUKTURES SE DATA QENDRES”**, që peshon mbi 45 mijë euro.
171. **“Pronet”**, kompani nga Prishtina (pronarin e të cilës nuk e kemi identifikuar në regjistrat e ARBK-së), nga KEK-u ka marrë tenderin **“Furnizim me Paisje komunikuese”** të vlefshme mbi 30 mijë euro.
172. **“Puntex”**, pronë e Ramadan Grazhda , Shpend Beqiri , Yrhan Shilik nag Prishtina në vitin 2009 nga KEK ka përfituar tenderin **“Furnizim me Mjete Mbrojtese ne Pune “**, që peshon mbi 40 mijë euro.
173. **“RACI doo”**, kompani nga Kroacia, personi kontaktuesi i së cilës nuk është gjendur, këtë vit është kontraktuar, si pjesë e një konzorciumi, nga KEK-u për tenderin **“Furnizim me instalim te pajisjeve për sistemin për monitorim kontinual te parametrave te gazrave ne oxhak : SO2 dhe NOx, Ne DGJE, Departamenti TC-« Kosova » B”**, tender që peshon mbi 310 mijë euro.
174. **“RE Engineering”**, që për pronarë ka: Patrik Mazreku , Mehmet Krasniqi , Fahredin Bekolli ,Sami Veliu , Samile Krasniqi , Selime Azemi , Behram Ajvazi , Nexhmedin Ahmeti , Sadete Limari, e person kontaktues Samile Krasniqin, në vitin 2008 është kontraktuar nga KEK-u për tenderin **“Furnizim me Elektromotorë për pompat furnizuese 6kV”**, që peshon mbi 480 mijë euro.
175. **“Rima”**, pronë e Riad , Nasir , Mirsad Mustafa nag Prishtina në vitin 2008 ka marrë 3 tenderë për furnizime në KEK, që së bashku peshojnë afro 40 mijë euro.
176. **“Rima Enginierig”** pronë e Fehmi Azemi e Patrik Mazreku, nga viti 2007 e deri në vitin 2001 nga KEK-u ka marrë mbi 3.5 milionë euro, vetëm te kategoria e tenderëve të mëdhenj. Për mos kryerje të punëve në vitin 2010 është dënua katërfish (për mos kryerje të punëve sipas kontratës, për 4 tenderë), por megjithëkëtë, në vitin 2011 ka marrë edhe 2 tenderë në vlerë mbi **gjysmë milioni euro.**
177. **“Ripten Enginiering”** me pronar Ismail Osmanaj e person kontaktues në tenderët e marrë në KEK Fatime Pacolli, nga kjo korporatë nga vitit 2007 e deri në vitin 2011, te tenderët mëdhenj, ka marrë tenderë në vlerë prej mbi **3.1 milionë euro.** Nga KEK në vitin 2010 është penalizuar për dy kontrata të pa realizuara sipas marrëveshjes, por me gjithë marrjen e dënimit,

kjo kompani është shpërblyer edhe në vitin 2011 me së paku tre tenderë të mëdhenj, vlera e të cilëve së bashku kalon shifrën prej mbi gjysmë milioni euro.

178. **“Salbatring”**, kompani nga Sllovenia (personin kontaktues të së cilës nuk e kemi gjetur), në vitin 2007 ka marrë një tender në vlerë mbi 285 mijë euro, tenderi është për **“Furnizim me Tavolina punuese 3 ( tre) fazore me tunele dhe ramë lëvizës”**.
179. **“Sankos”**, pronë e Shefik Nezirit nga Kaçaniku, në vitin 2010-2011 ka marrë në KEK tenderë në vlerë afro 180 mijë euro.
180. **“Siemens”**, përfaqësi nga Kroacia, që për person kontaktues në Kosovë ka Duro Drzaic, në vitin 2009, nga kategoria e tenderëve të mëdhenj të KEK-ut është shpërblyer me dy tenderë që peshojnë së bashku **mbi 3.2 milionë euro**. Në vitin 2010, për mos përmbushje të kontratës nr. 6105 **“Fur. Me el. Filltra”**, vlera e së cilës ishte mbi 60 mijë euro, **“Siemens”** u penalizua nga KEK-u.
181. **“SNR Group Kosova”**, pronë e Aziz Berishës nga Prishtina, në KEK në vitin 2008-2011 ka marrë tenderë në vlerë afro 150 mijë euro.
182. **“Solar & Ortex Uro Group”**, pronë e Bekim Pirevës, në vitin 2011 nga KEK-u ka marrë tre tenderë për furnizime të cilët peshojnë mbi 570 mijë euro.
183. **“Takraf”**, kompani nga Gjermania, përfaqësia në Kosovë është e regjistruar në pronësi të Fehmi Azemit dhe **“TAKRAF GmbH”**, e për person kontaktues ka Holger Lieberëirth, nga KEK-u ka marrë dy tenderë, një në vitin 2008 dhe një 2010. Në vitin 2008 mori tenderin **“Blerja e dy ekskavatorëve rotorik për Minierat e Qymyrit në KEK”**, që peshon 40,874,600 euro , kurse në vitin 2010 tenderin **“FURNIZIM ME SHIRIT VETELIVIZES (te ri) BRs 1.400- 29/32, ME MONTIM, MBIKQYRJE, KOMISIONIM dhe DOREZIM TE PAISJES “**, që peshon **4,991,468 euro**.
184. **“Tekno X Group Kosovo”**, pronë e Vehbi Iberi , Gani Shashivari , Corrado Segre , Giancarlo Bertoluzzo , Dražen Jergovic , Adrian Kostaqi -TEKNOXGROUP SA, e që person kontaktues në tenderët e marr në KEK ka Gani SHashivarin, në këtë korporatë ka marrë dy tenderë të mëdhenj për furnizim me ekskavatorë e pjesë rezervë për ta. Tenderët u fituan në vitin 2008 dhe së bashku peshojnë **mbi 2 milionë euro**.
185. **“ThyssenKrupp Fordertechnik GmbH”**, kompani gjermane, përfaqësia e së cilës në Kosovë është regjistruar në emër të Ariana Salihu - Rozhaja , Gerd Egon Moraëski – e **“ThyssenKrupp Fordertechnik GmbH”**. Si persona të autorizuar në Kosovë janë shkruar Ariana **Salihu-Rozhajë e Thomas Meyer**. Po për këtë kompani, në një prononcim për media në vitin 2010, **Mehdi Zhugolli** i kompanisë **“Eco-Trade”**, vëlla i të cilit është financues i PDK-së, ka thënë se është përfaqësues i kësaj kompanie në Kosovë . Ai atëherë pati deklaruar se ka përfaqësitë e

kompanive më të mëdha botërore për industrinë e rëndë, siç janë: “ThyssenKrupp-Fordertechnik”, “Schaeffler Technologies GmbH & Co.Kg”, “Voith”, dhe “Tribotec”, të gjitha këto nga Gjermania, dhe kompanin “SIEMENS Industry” nga Austria dhe “Komatsu” nga Japonia. Kjo kompani, “ThyssenKrupp Fordertechnik GmbH” brenda viteve 2008-2010 nga KEK-u ka marrë tenderë në vlerë mbi **54.8 milionë euro**.

186. **“Turbo Care”**, kompani Polake që për persona të autorizuar ka Janusz Oloëski dhe Krysstof Dudzinski, në vitin 2008 është shpërblyer me tenderin “Riparimi I Rotorit Të Cilindrit te Trusnisë se Ulet i BLOKUT A3” që peshon 198,298 euro. Në vitin 2012 ka marrë tenderin “Riparimi kapital i turbines se avullit dhe gjeneratorit elektrik” që peshon 2,835,003 euro.
187. **“Ukab”** pronë e Burim Ukës, e që te tenderët e KEK-ut pos tij, si person kontaktues paraqitet edhe Ilir Gashi, prej viti 2007-2010 ka marrë nga kjo korporatë tenderë në vlerë mbi 8.4 milionë euro. Tenderët kjo kompani i ka marrë edhe si e vetme e edhe me konzorciume dhe natyra e punëve është edhe furnizim, por edhe shërbime me punë.
188. **“Unikat”**, pronë e Xhavit Çollakut nga Peja në KEK në vitin 2009 ka marrë tenderin “Furnizim me Mjete Mbrojtëse ne Punë” të vlefshëm prej afro 315 mijë euro.
189. **“Unikosprojekt”**, pronë e Besnik Nikqit , Arber Shita - „Komtel Projekt Engineering” Sh.p.k. (**“Komtel Projekt Engineering”**, kompani në pronësi të Vegim Gashit, kandidat i AKR-së për Kryetar të Prishtinës në vitin 2009, dhe që kur u krijua kishte si bashkë-aksionar edhe Fadil Ismajlin , atëherë njëri nga menaxherët e KEK-ut, tash Kryshef i KOSTT-it, nga KEK-u, te kategoria e tenderëve të mëdhenj, nga KEK ka përfituar tre tenderë për furnizime që peshojnë mbi 1 milionë euro. Tenderët janë dy të vitit 2009 dhe një i vitit 2011). **“Unikosprojekt”** në vitin 2008 ka marrë tenderin “Ekrani mbrojtës me injektin i shtratit te lumit Sitnica”, që peshon mbi 370 mijë euro.
190. **“UNION”**, me pronar Shemsi Bajgora që nga viti 2007 e deri në vitin 2011 nga KEK , nga kategoria e tenderëve të mëdhenj, ka marrë tenderë në vlerë afro 590 mijë euro. Ndonëse në vitin 2010 u penalizuar për mos përmbushje të dy kontratave, kjo kompani në vitin 2011 ka marrë edhe 4 tenderë.
191. **“Unioni”**, kompani nga Prishtina, (pronarin e së cilës nuk kemi mundur ta identifikojmë në regjistrat e ARBK-së), në vitin 2007 nga KEK-u ka marrë tenderin “Furnizim me: Pjese për aftësimin e Mekanizmit Ndhimes LOT 6 Pjese nderrimi-Goma”, të vlefshëm mbi 200 mijë euro.
192. **“Valfrigo”**, kompani nga Peja, pronë e Valdet Tahirit, nga KEK ka marrë tre tenderë, prej vitit 2009-2011, vlera e të cilëve është më e madhe se 450 mijë euro.
193. **“Valterio”**, kompani nga Zvicra, që përfaqësia në Kosovë është regjistruar në pronësi të Sevime Krasniqi , Eric Fostier , Grone Sion – “Grichting & Valterio S.A.”, është kompani që ka marrë hise në konzorcium, në tenderin “Dizajnimi, Ndërtimi dhe Komisionimi i Objekteve ElektroEnergjetike në RAHOVEC”, tender i viti 2007 që peshon **5,773,905 euro**. “Grichtng”,



kompani po ashtu nga Zvicra ishte pjesë e këtij konzorciumi. Kësaj të fundit nuk i dihet personi kontaktues.

194. **“Vam Trade”**, pronë e Xhemail Ismajlit nga Prishtina në KEK ka marrë në vitin 2007 e 2008 tre tenderë për furnizime me vlerë mbi 160 mijë euro.
195. **“Vatro Promet”**, kompani nga Kroacia, që për person kontaktues në Kosovë e ka Nenad Radojčić, nga KEK-u ka marrë një tender prej afro 520 mijë eurosh në vitin, dhe tenderi është për **“FURNIZIM ME AUTOMJETE PËR ZJARREFIKSA – CISTERNA”**.
196. **“Viktoria Invest”**, pronë e Arben Dakajt nga Suhareka në vitin 2007 ka marrë tenderin **“Lot I ( FURNIZIM ME SHTYLLA BETONI)”**, që peshon 174,708 euro.
197. **Kompania “Vlezerit Mustafa”** nga Drenasi në vitin 2009 u kontraktuan nga KEK-u për **“FURNIZIM ME: PESHOJA ELEKTRONIKE PER KAMIONA”**, tender që vlen 111 mijë euro.
198. **“Wamar internacional”**, kompani që për person kontaktues ka Bernard Fernando, në KEK në vitin 2009 ka marrë dy tenderë për furnizime në vlerë mbi 190 mijë euro.
199. **“XANI NEX”**, që për pronar ka **Isa Hajdinin**, prej vitit 2008 e deri më tani, nga kategoria e tenderëve të mëdhenj në të cilat ka hulumtuar **“Preportr”**, ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 8.8 milionë eurosh. Në vitin 2010 ishte penalizuar nga KEK për mos realizim të 7 kontratave, por megjithëkëtë, në vitin 2011 dhe 2012, kjo ka marrë edhe tri kontrata publike në vlerë të madhe, që së bashku peshojnë **afro gjysmë milioni euro**. Edhe kompania **“Mahagoni”**, figuron të jetë në pronësi të **Isa Hajdinit** nga Prishtina e që në vitin 2009 u angazhua nga KEK-u për **“Furnizim me Enterier dhe punimi i paravaneve për DFU”**, tender që peshon mbi 160 mijë euro.
200. **“ZPA Smart Energy”**, kompani nga Çekia, që përfaqësia në Kosovë është regjistruar në pronësi të Lutfi Gashi e Zdenek Prokop në KEK, te tenderët e mëdhenj ka marrë tenderin **“FURNIZIMI DHE LIFERIMI I NJEHSCOREVE TE ENERGIJE ELEKTRIKE PER KONSUMATORET SHTEPIAK për KEK.SHA”**, që peshon **mbi 1.3 milionë euro**. Në këtë tender si person kontaktues, kjo kompani ka pasur Michaela Capkova.

## **Metodologjia e hulumtimit**

*Preportr ka hulumtuar pjesën më të madhe të tenderëve me vlerë të madhe në KEK që nga gjysma e dytë e vitit 2007 e deri më tani. Në këtë hulumtim ka identifikuar 200 kompani përfituese të mbi 500 tenderëve të kësaj kategorie që së bashku peshojnë mbi 550 milionë euro.*

*Gjatë hulumtime Preportr ka hasur në kontrata të mëdha që teknikisht a qenë e pa mundur të lexohen, në Faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe në të njëjtën kohë edhe në kontrata që ju mungon vlera e përgjithshme me të cilën është shpërblyer kompania e caktuar dhe me vlera të paqarta.*

*Një pengesë serioze e këtij hulumtimi ka qenë Zyra për Informim e KEK-ut. Megjithëse Preportr në vazhdimësi të hulumtimi, për po thuajse të gjitha çështjet, konstatimet që janë përfshirë, ka dërguar pyetje e kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, në KEK nuk pasur përgjigje, përveç kërkesës për ti pasur listat e kontraktorëve të KEK-ut të angazhuar përmes prokurimeve prej vitit 200 e deri më tani.*